

## **Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë në mbyllje të vitit 2012**

*Dr. Din Abazaj*

*President i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë*

*28 Dhjetor 2012*

Edhe këtë vit që po mbylлим, e gjithë veprimtaria e Urdhrit të Mjekëve ka qenë e fokusuar në përmbushjen e misionit thelbësor të tij që është përmirësimi i cilësisë së kujdesit shëndetësor dhe mbrojtje e të sëmurëve dhe publikut nga kequshtrimi i mjekësisë. Edhe sot e në të ardhmen, ky është dhe do të jetë misioni i Urdhrit të Mjekëve, i cili bëhet i mundur nëpërmjet një angazhimi të gjithanshëm dhe të një bashkëpunimi të ngushtë ndërinstytucional dhe ndërpartnerial me aktorë e faktorë të tjerë të sistemit, gjë që, ne e kemi realizuar më së miri këtë vit.

Në funksion të këtij qëllimi dhe synimi, Urdhri i Mjekëve ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë, me Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe me Qendrën Kombëtare të Edukimit të Vazhdueshëm Mjekësor, tri nga kolonat kryesore e më të rëndësishme të sistemit shëndetësor.

Ky bashkëpunim po funksionon mirë dhe ka një impakt pozitiv në strategjinë e përbashkët për rritjen dhe përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor në vend. Kështu është arritur të institucionalizohet sistemi i kontrollit të standardeve profesionale, i kompetencës dhe performancës së mjekëve përmes Edukimit të Vazhdueshëm Mjekësor dhe formave të tjera.

Është institucionalizuar sistemi i liçensimit dhe ri-liçensimit të mjekëve dhe stomatologëve si masa e fundit e këtij kontrolli dhe vlerësimit, me anë të të cilit janë vënë në kontroll, shërbimet publike dhe ato të sistemit privat.

Ky proces, i cili është në fazën e përkryerjes dhe përfundimit të tij, rrit dhe përmirëson cilësinë e kujdesit shëndetësor dhe e bën atë më të sigurt.

Në zbatim të Ligjit "Për Profesionet e Rregulluara në RSH", janë marrë masa të nevojshme, janë hartuar rregulloret dhe aktet normative për organizimin me sukses dhe efikasitet të plotë të praktikës profesionale dhe provimit të shtetit për mjekët dhe stomatologët e sapo diplomuar.

Janë shqyrtuar dhe zgjidhur me shumë përgjegjësi ankesat e të sëmurave dhe publikut të mbërritura në Urdhrit të Mjekëve.

Është stabilizuar dhe mbahet i kontrolluar buxheti i Urdhrit, i cili ka mundësuar përmirësimin e shtypit periodik, si dhe zgjerimin dhe perfeksionimin e strukturave dhe funksioneve të Urdhrit.

Urdhri i Mjekëve kryen funksionet e tij në kontekstin e një sistemi shëndetësor në reformim e zhvillim të vazhdueshëm, gjë që ka ndikuar në rishikimin dhe përshtatjen e akteve normative që kodifikojnë veprimtaritë e Urdhrit.

Gjatë këtij viti, ne kemi ripunuar një sërë aktesh normative, por më i rëndësishmi është ripunimi dhe pasurimi i Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, i cili është hartuar këtë vit dhe është vënë në dispozicion të të gjithë mjekëve dhe stomatologëve të sistemit publik dhe privat.

Ky vit ka shënuar një rritje dhe përmirësim të dukshëm të bashkëpunimit me organet e medias, gjë që ka ndihmuar në rritjen e informimit dhe transparencës me publikun dhe bashkësinë e mjekëve. Falë këtij bashkëpunimi, organet e medias kanë rritur nivelin e njohjes dhe kanë vlerësuar e pasqyruar me më objektivitet punën dhe zhvillimet e Urdhrit dhe të sistemit shëndetësor në përgjithësi.

Gjej rastin t'ju falenderoj sinqerisht për këtë, duke ju sjellë urimet më të mira për këtë Vit të Ri, dhe të premtoj se Urdhri i Mjekëve do të jetë vazhdimisht një derë e hapur për një bashkëpunim të mëtejshëm dhe të frytshëm.

Këto arritje u dedikohen punës së palodhur dhe përkushtimit të të gjithë Këshillave Rajonale të Urdhrit të Mjekëve, të cilët meritojnë përgëzime dhe urime të veçanta.

Viti 2013 është vit jubilar i 20 vjetorit të krijimit të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, i cili do të jetë vit aksioni me prioritet rritjen e cilësisë së Edukimit të Vazhdueshëm Mjekësor dhe formimit profesional-shkencor dhe etik të mjekëve, të bazuara në parimet e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, standardeve dhe detyrimeve që ai parashikon në praktikën e tyre mjekësore.

Në përfundim, i përshëndes dhe përgëzoj mjekët dhe stomatologët në mbarë vendin për punën dhe përkushtimin, në shërbim të të sëmurëve dhe gjithë publikut, dhe gjej rastin që t'ju drejtoj urimet e mia dhe të Këshillit Kombëtar të UMSH-së, për një vit të ri të mbarë e të suksesshëm në punën e tyre të fisshme dhe humanitare, shëndet, dashuri, gëzime në familjet e tyre.

*Ju faleminderit,*

This document was created with Win2PDF available at <http://www.win2pdf.com>.  
The unregistered version of Win2PDF is for evaluation or non-commercial use only.  
This page will not be added after purchasing Win2PDF.